



A.nr.330/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 330/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesja A.G, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat Shkëlqim Jakupi, kundër organit të punësimit: Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, në mbështetje të nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3, dhe nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet ankesa me numër A.nr. 330/2026, e datës 24.03.2026, e parashtruar nga ankuesja A.G.

II. Anulohet shkresa me numër protokolli 288 e datës 16.03.2026 e Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës që ankuesen ta kthej në pozitën sipas akt emërimit të datës 13.04.2012.

A r s y e t i m

Ankuesja A.G (me tej referuar vetëm ankuesja), përmes përfaqësuesit me autorizim avokat Shkëlqim Jakupi më datë 24.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.330/2026, kundër kërkesës së datës 16.03.2026 të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Fushe Kosovës,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 31.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 21.04.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1462/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2026; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 24.03.2026; Kërkesë për kthimin e zyrtares nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë tek Drejtoria sipas Akt

emërimit 357, të datës 13.04.2012, me numër protokolli Nr.288, e datës 16.03.2026; Akt emërimi i ankueses A.G, me numër protokolli Nr.1639, i datës 04.09.2025; Akt emërimi i ankueses A.G me numër protokolli Nr.1354, i datës 21.09.2023; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses A.G; Autorizim; Përgjigjen në ankesë të datës 21.04.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Akt emërimi i A.A i datës 20.04.2012; Konfirmim për përfundimin e konkurrimit me numër protokolli Nr.1354 i datës 21.09.2023; Konkursi me numër reference RN00012135, i datës 20.07.2023;

Kolegji i Këshilli duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e palejuar, *sepse*.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit, të datës 20.04.2012, ka themeluar marrëdhënien e punës në pozitën “*Nëpunëse e teknologjisë informative*”, në Sektorin e Logjistikës në Komunën e Fushë Kosovës. Tutje me datë 20.07.2023 Komuna e Fushë Kosovës sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë ka hap Konkursin për ngritje (avancim) në detyrë, për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë, Kadastër, dhe Pronë, në të cilin konkurs aplikon edhe ankuesja dhe e njëjta ka rezultuar kandidate fituese, ndërsa më datë 21.09.2023 i është lëshuar Akt Emërimi për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publik, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, më datë 14.08.2025, ankueses i ka lëshuar Akt Emërimin për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë me mandat katër (4) vjeçar nga data 17.06.2025 deri më datë 16.06.2029.

Kryetari i Komunës së Fushe Kosovës me datë 16.03.2026 përmes kërkesës me numër protokolli 288 i drejtohet Udhëheqës se Njesisë se Burimeve Njerëzore që të bëjë kthimin e zyrtares ankueses nga pozita e Udhëheqëses për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në pozitën sipas aktit të emërimit të datës 13.04.2012.

Aneksja e pa kënaqur me kërkesën e Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës përmes përfaqësuesit me autorizimin me datë 24.03.2026 ka parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim se Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës me rastin e parashtrimit të kërkesës së datës 16.03.2026, ka shkel parimet e përgjithshëm të LPPA-se dhe detyrimeve të LZP-se, shkelje të procedurave administrative dhe disiplinore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të ligjit material, po ashtu e njëjta pretendon se detyrat dhe përgjegjësit e ankueses burojnë vetëm nga akti i emërimit të datës 04.09.2025, dhe se e njëjta nuk mbanë asnjë përgjegjësi për aktet të cilat nuk kanë fuqi juridike dhe si të tilla nuk mund të prodhojnë asnjë lloj pasoje.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të çështjes, ka konstatuar se fillimisht ankuesja sipas Akt Emërimit, të datës 20.04.2012, ka themeluar marrëdhënien e punës në pozitën “*Nëpunëse e teknologjisë informatike*”, mirëpo sipas konkursit me Nr. Reference: RN00012135 për ngritje në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë, e njëjta ka themeluar marrëdhënie punës sipas Akt Emërimit të datës 21.09.2023, sipas dispozitave të aplikueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit me Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-për Zyrat Publik, ankueses më datë 14.08.2025, i është lëshuar akt emërimi me mandat katër (4) vjeçar, me efekt nga data 17.06.2025. Rrjedhimisht është fakt i pakontestueshëm që Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, më datë 16.03.2026, i është drejtuar Udhëheqëses se Njesisë së Burimeve

Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës, me Kërkesë për kthimin e zyrtares nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë tek Drejtoria sipas Akt Emërimit 357, të datës 13.04.2012, mirëpo sipas emailit të datës 13.05.2026 të dërguar nga Zyrtarja e Lartë e Personelit të Komunës së Fushë Kosovës e njëjta ka njoftuar: *“Në lidhje me nëpunësen A.G, ju njoftoj se nuk është marr asnjë vendim për ndërrim të vendimin të punës dhe gjithashtu nuk ka as ndryshime në listën e pagave”*.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në provat materiale të lëndës, konstaton faktin se ankueses nuk i është shfuqizuar akti i emërimit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk është kthyer në pozitën sipas Akt Emërimit 357, të datës 13.04.2012, pra nuk ka asnjë akt administrativ me të cilin kërkesa e datës 16.03.2026 e Kryetarit të Komunës është trajtuar, e për rrjedhojë sipas provave të çështjes, rezulton se ankuesja është duke e ushtruar pozitën sipas Akt Emërimit të datës 14.08.2025, por Kolegji pavarësisht që nuk është ndërmarr asnjë veprim nga organi punëdhënës konstaton se kjo shkresë duhet të anulohet duke ikur nga formalizmat juridike të tepruar ashtu siç ka konstatuar edhe Gjykata Kushtetuese, është e pa kontestueshme që kjo shkresë nuk ka shkaktuar pasoja juridike por me qenë së është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 37 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj, pra lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësit të shërbimit civil gjithherë duhet marr parasysh dispozitat ligjore në fuqi dhe respektimin e parimeve të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: 1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit dhe parimeve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, dhe si rrjedhojë duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht të aprovoj në tërësi ankesën e ankueses si të bazuar.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr. 330/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtëse

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses avokat Shkëlqim Jakupi;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.